



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 18 maj 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Adem Hajdaraj, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Adem Gani Geci, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selvije Halimi, Radmila Vujović dhe Kolë Berisha.

Mungoi: Mufera Şinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hilmi Jashari – IAP, Violeta Rexha – EULEX, Jeton Gyryqi dhe Jerina Dompier - OSBE, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit në bashkëpunim me grupin e punës dhe me ekspertët e caktuar nga Komisioni,
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit në bashkëpunim me grupin e punës dhe me ekspertët e caktuar nga Komisioni

Kryetari – I përshëndeti anëtarët e pranishëm të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione. Tha se mbledhja po mbahet me anëtarët e grupit të punës, sepse jemi të interesuar që Projektligji të procedohet brenda afatit ligjor. Kërkoi nga kryesuesi i grupit të punës, Bajram Kosumi, ta njoftonte Komisionin deri ku kishte arritur ta shqyrtonte Projektligjin.

Bajram Kosumi - Njoftoi se Projektligji ishte shqyrtuar deri te neni 12 dhe se më 19. 5. 2010, në orën 9:00, do të mbahet takimi i radhës së grupit të punës, që sa më parë të përfundohet me procedimin e tij. Procedoi me nenin 12 të Projektligjit - Shkarkimi nga funksioni i Avokatit të Popullit dhe i zëvendësve të tij.

Ibrahim Makolli - Iu referua nenit 12, paragrafi 1.2. Sipas Projektligjit, del se Avokati i Popullit duhet të dënohet me vendim të formës së prerë, por nuk mund t'i nënshtrohet procedurave gjyqësore pa iu marrë imuniteti. Për këtë i mori shembull vendet e tjera që e kanë rregulluar çështjen, kur “*ka kryer veprë penale të dënueshme me 6 ose më tepër muaj burgim*”. Në momentin kur akuzohet për veprë penale, që parasheh dënim më se 6 muaj burgim, para se të përfundojë gjykimi duhet të shkarkohet. Ishte i mendimit se Avokatit të Popullit së pari duhet t'i merret imuniteti, pastaj të gjykohet për veprë penale.

Armend Zemaj - Sqaroi se Avokati i Popullit gëzon imunitet vetëm për veprimtarinë që e ushtron, jo edhe për çështje të tjera.

Bajram Kosumi - Kërkoi të mos ngatërrohen çështjet, sepse neni 11, që flet për imunitet e mbron Avokatin e Popullit për punën që e ushtron, ndërsa për të gjitha çështjet që i ushtron, por nuk bien në fushëveprimin e tij, nuk gëzon imunitet dhe për to përgjigjet si çdo qytetar. Këtë e përcakton neni 12, paragrafi 1.2 , në të cilin thuhet: *kur Kuvendi obligohet ta shkarkojë*.

Në vazhdim propozoi që në nenin 12, paragrafi 1, pika 1.4, pas fjalëve, nenit 7, duhet të jetë: “*paragrafi 1 dhe 2*”, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni, në rreshtin e pestë hiqet fjalia: “*ose suspendimin e përkohshëm* “. E njëjta fjali hiqet edhe në paragrafin 3.

Luljeta Shehu - Propozoi që në nenin 13, në titull, fjala: “*Mbarimi*”, të zëvendësohet me: “*Përfundimi*”.

Bajram Kosumi - Propozoi që në nenin 13 paragrafët 1.2, 1.3 dhe 1.4 të nisin me pjesëzën “*me*”, kurse në paragrafin 1.4, pas fjalëve: “*funksion dhe*” të shtohen fjalët “*përkatesisht 3 vjet për zëvendësit*”.

Me propozimet e Hilmi Jasharit, neni 13, paragrafi 2, riformulohet si vijon: “*2. Në rast të mungesës së përkohshme, të paaftësisë së përkohshme, Avokati i Popullit, zëvendësohet nga zëvendësi kryesor*” dhe vazhdon fjalia.

Në vazhdim të shtohet paragraf i ri “2.2. Në rast të mungesës së përhershme, të paaftësisë së përhershme, të shkarkimit ose të vdekjes, Avokati i popullit zëvendësohet nga zëvendësi kryesor deri në zgjedhjen e Avokatit të ri të Popullit.”

Adem Hajdaraj - Propozoi që në nenin 13, paragrafi 3, në vend të: “në rast skadimi “duhet të jetë: “me skadimin”.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që shqyrtimi i mëtejme i Projektligjit të bëhet nga grupi i punës, i cili do ta mbajë takimin e radhës me 19. 5. 2010, në orën 9:00.

3. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni